



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:034874

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05104965

C-III.-12-0040

Paditësja:

H K, Fushë Kosovë.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Ramiz Sadiku”, Prishtinë, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**,
Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur me 21 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE

- 1. Padia e paditëses hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 16.01.2012, paditësja ka paraqitur padi me të cilin ka kërkuara nga Gjykata që të merr vendim që e zëvendëson kontratën mbi shitblerjen e banesës, e cila banesë gjendet në Prishtinë ‘B. D’ në sipërfaqe prej 79,86 m2. Paditësja si provë ka bashkangjitur: kontratën mbi shfrytëzimin e banesës nr..... të dt....., të lidhur me BVI-në, vendimin nr. 1372 të dt.07,07.1988 të komisionit për ndarjen e banesës, si dhe një kontratë të lidhur në mesë të paditëses dhe OPPB KNI “Ramiz Sadiku” OP Ndërtimtaria BP Shërbimet e përbashkëta si pronare e banesës.

Me 24.08.2015, e paditura ka paraqitur mbrojtje në padi dhe ka theksuar se paditësja ka paraqitur padinë në kundërshtim me nenin 18.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke theksuar se çështja e ngritur nga paditësja është çështje administrative dhe se Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion në këtë lëndë. Ka shtuar se nga shkresat e lëndës del se paditëses Komisioni për shitjen e banesës i ka aprovuara kërkesën për blerje të banesës. E paditura mbrojtjes i ka bashkangjitur njoftimin nr.1956 të dt.23 09 2013 me të cilën paditëses i është aprovuar kërkesa për blerje të banesës.

Me 04 shtator 2015, Gjykata ka tentuar të dorëzoj mbrojtjen e AKP-së tek paditësja, por ka qenë e pamundur për shkak se paditësja e ka ndërruar adresën të cilën e kishte dhen fillimisht në padi.

Gjykata përmes urdhrit të dt. 14 nëntor 2023, i ka ftuar palët për një seancë dëgjimore me dt. 21 dhjetor 2023.

Me 06 dhjetor 2013, djali i paditëses R K ka paraqitur një parashtrësë në gjykatë dhe ka theksuar se lidhur me këtë çështje për të cilën ekziston padija, paditësja e ka zgjidhur këtë çështje me AKP-në. I njëjti i ka bashkangjitur parashtrësës në kopje letërnjoftimin e tij.

Gjykata mbajti seancë dëgjimore me 21 dhjetor 2023, por paditësja nuk prezantoi në seancë.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditëses hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimi të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 21 dhjetor 2023, në ora 9:30, Kolegji ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Në Gjykatë nuk u paraqit paditësja edhe pse ishte ftuara në mënyrë të rregullt. Përfaqësuesi i të paditurës së parë AKP, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata konstaton se paditësja është ftuara në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar. Ftesa për seancë ishte pranuar me 06 dhjetor 2023. Gjykata nënvizon se me urdhrin për caktimin e

seancës i ka njoftuara palët se nëse dështojnë të paraqiten në seancën dëgjimore, gjykata përsëri mund ta gjykoj lëndën dhe të merr vendim mbi meritat apo të lëshoj Aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga paditësja, me të cilin do të theksonte arsyet për mos prezencën e saj në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës së parë AKP që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykimi të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Bajram Miftari, Gjyqtar